

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6810
E martë, 24 janar 2023
çmimi 0.40

Presidentja Osmani pritet nga Papa Francesku në Vatikan



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

MBAHET PROTESTA "KRYEMINISTËR, MOS NA SHKEL NË GJAK!
STOP DEVIJIMIT TË HISTORISË" | PAGE 4-5

FËMIJËT E DËSHMORËVE KËRKOJNË DORËHEQJEN E KURTIT PAS DEKLARATËS PËR IVANOVIQIN



Fëmijët e dëshmorëve të UÇK-së kanë protestuar të hënën kundër deklaratës së kryeministrit Albin Kurti për politikanin e ndjerë serb, Oliver Ivanoviq. Me moton "Kryeministër, mos na shkel në gjak! Stop

devijimit të historisë", një numër i konsiderueshëm i tyre janë mbledhur para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës. Një nga iniciatorët e protestës, Berat Beqiri, ka kërkuar nga Kurti të japë dorëheqje. "Deklaratat e

pamatura do të pasohen me kundërshtimin tonë dhe me kërkesat tona për dorëheqje. Ky veprim i Kurtit ishte një tronditje e radhës dhe një fyerje e rëndë për të gjithë ne", ka theksuar ai

**ENDE S'ËSHTË
CAKTUAR VLERA E
KOEFIICIENTIT, TË
PUNËSUARIT NUK E
DINË SA DO TA KENË
PAGËN NË MUAJIN
SHKURT** | PAGE 8



**DANIMARKA ENDE PO
PRET HUAZIMIN E
QELIVE TË KOSOVËS** | PAGE 5

AKTUALE



**PAS VËRSHIMEVE NË SKENDERAJ,
KRYETARI NURA BËN THIRRJE PËR
NDIHMË** F. 6

**ABDIXHIKU: SKANDALET ME
BERISHAJN DHE IVANOVIQIN NUK
MUND TË KALOHEJN NË HESHTJE** F. 3

**KURTI KËRCON NGA MINISTRAT MË
SHUMË ANGAZHIM** F. 3

EKONOMI



**ROZETA HAJDARI:
EDHE 400 VENDE TË REJA
TË PUNËS PËR QYTETARËT** F. 3

EKONOMI



**PËRBALLJA E KAMPIONEVE NË
LIGËN UNIKE** F. 10

RENOVA
Mopedat
Xingyink -Tefevë
Gurte-Verzaj
PUTZ
Tel: +381 44 487 302 / +381 44 487 303
+381 44 487 755
Fax: +381 44 487 303
Më: +381 44 501 289
E-mail: renovamt.net.mk

PRINCESHA
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princessha-kc.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL • BUNJAKOL • CUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
018 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP BILA
DEJA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 10339 246 301 Fax: +381 10339 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Erdogani shpall datën e zgjedhjeve në Turqi



ANKARA, 23 JANAR - Presidenti i Turqisë ka shpallur 14 majin datë për mbajtjen e zgjedhjeve të ardhshme parlamentare dhe presidenciale të vendit. Presidenti Rexhep Tajip Erdogan, i cili planifikon të rikandidojë, e bëri njoftimin gjatë një konference rinore të shtunën, në provincën veriperëndimore të Bursës. Videoja e ngjarjes u publikua të dielën, më 22 janar. "Jemi të destinuar të ndajmë rrugën tonë me ju, rininë tonë, që do të votojë për herë të parë në

zgjedhjet që do të mbahen më 14 maj", tha presidenti turk. Erdogan, i cili është në pushtet që nga viti 2003, fillimisht si kryeministër dhe si president që nga viti 2014, përballet me zgjedhjet më shpues për të deri tani. Ai kandidon në këto zgjedhje teksa mbështetja për të ka rënë pas krizës ekonomike, e cila bëri që inflacioni të arrinte në 85 për qind vitin e kaluar. Opozita ka fajësuar Erdoganin për rënien ekonomike të Turqisë, për shkeljen e të

drejtave dhe lirive civile, duke thënë se në dekadën e dytë në pushtet, ai ka shfaqur qëndrim autoritar. Erdogan, 68 vjeç, prezantoi një sistem qeverisjeje në vitin 2018 që shfuqizoi zyrën e kryeministrit dhe përqendroi shumicën e pushteteve në duart e presidentit. Pozita e presidentit në Turqi, deri në atë vit, ishte kryesisht ceremoniale. Sipas sistemit të ri, zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare mbahen në të njëjtën ditë.

Spanja shkatërron bandën kriminale që shfrytëzonte refugjatët ukrainas

MADRID, 23 JANAR - Policia spanjolle njoftoi se ka shkatërruar një bandë kriminale që drejtonte tri fabrika ilegale të duhanit në vend, në të cilat refugjatët ukrainas po punonin në kushte të rënda. Autoritetet e Spanjës njoftuan se bastisjet u kryen në tri lokacione të ndryshme dhe se 27 persona janë arrestuar. Sipas tyre, fabrikat ishin në gjendje të prodhonin më shumë se gjysmë milioni

paketa cigaresh në ditë, të cilat shiteshin në të gjithë Spanjën dhe jashtë saj. Policia tha se ukrainasit, të cilët kishin ikur nga pushtimi rus në vendin e tyre, jetonin "të ngjeshur" nëpër strehimore të improvizuara brenda fabrikave. Në deklaratën e policisë thuhet se punëtorët ukrainas të përfshirë në operacion jetonin në kushte të vështira, punonin me orare të gjata dhe nuk largoheshin kurrë nga aty,

pasi disa kishin hyrë ilegalisht në Spanjë. Ndërkohë, sipas policisë, drejtuesit e bandës raportohet se kanë pastruar shuma të mëdha parash dhe se jetonin në luks, në qytetin turistik Marbella. Aksioni është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme të autoriteteve spanjolle për t'i luftuar aktivitetet e paligjshme, përfshirë pastrimin e parave dhe kontrabandën.



BE-ja shqyrton mundësinë e përdorimit të aseteve të ngrira ruse për rindërtim të Ukrainës



BRUKSEL, 23 JANAR - Bashkimi Evropian po shqyrton përdorimin e aseteve të ngrira të Bankës Qendrore të Rusisë me vlerë prej 300 miliardë dollarësh për të gënjatur fitime për rindërtimin e infrastrukturës së shkatërruar të Ukrainës. Presidenti i Këshillit Evropian,

Charles Michel, u ka bërë thirrje qeverive të Bashkimit Evropian që t'i vazhdojnë konsultimet se si mund të përdoren këto asete të ngrira, raportoi "Financial Times" më 23 janar. Michel tha se do të analizohet mundësia për të gënjatur fitime të cilat më pas mund të drejtohen drejt përpjekjeve për

rindërtim, raportoi gazeta britanike. Sipas Michel, asetet do t'i kthehen shtetit rus nëse nënshkruhet një marrëveshje paqeje. Blloku evropian, i përbërë prej 27 shteteve anëtare, ngriu fondet ruse në përgjigje të pushtimit të paprovokuar të Ukrainës nga Moskua.

Ministrat e BE-së vendosin sanksione të reja kundër Iranit

BRUKSEL, 23 JANAR - Ministrat e Bashkimit Evropian ranë dakord për një paketë të re sanksionesh kundër Iranit, tha presidenca suedeze e BE-së më 23 janar. "Ministrat miratuan një paketë të re sanksionesh kundër Iranit, që shënjestrojnë ata që nxisin represionin. BE-ja dënon fuqishëm përdorimin brutal dhe joproporcional të forcës nga autoritetet iraniane kundër protestuesve paqësorë", ka njoftuar presidenca suedeze

në një postim në "Twitter", pa dhënë detaje të tjera. Burimet i thanë agjencisë së lajmeve "Reuters" javën e kaluar se ministrat e Jashtëm të BE-së do të shtojnë 37 individë në listën e sanksioneve të BE-së kundër Iranit më 23 janar. Të paktën 522 persona janë vlarë përgjatë katër muajve të protestave kundër Qeverisë së Iranit, sipas raportimeve të organizatës HRANA me bazë në Shtetet e Bashkuara. Gati 20 000 persona janë arrestuar,

prej tyre 110 kanë akuzë që mund të rezultojnë me dënime me vdekje. Sipas të dhënave, katër protestues tashmë janë ekzekutuar. Protestat janë mbajtur në më shumë se 160 qytete prej nisjes së tyre në shtator të vitit të kaluar. Protestat janë nxitur nga vdekja e 22-vjeçares Mahsa Amini, kurdo-iraniane, sa ka qenë në mbajtje policore, me arsyetimin e nuk e ka vendosur si duhet mbulesën në kokë.



Abdixhiku: Skandalet me Berishajn dhe Ivanoviçin nuk mund të kalohen në heshtje

PRISHTINE, 23 JANAR (ER) - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka kritikuar sërish Qeverinë e Kosovës lidhur me çështjen e ambasadorit Martin Berishaj dhe Oliver Ivanoviçit. Abdixhiku përmes një postimi në "Facebook" ka shkruar se është ende në pritje të veprimeve, derisa ka thënë se kjo qeveri po amnistion Martin Berishajn e po rehabiliton Oliver Ivanoviçin. "Amnistues të Martin Berishajt. Rehabilitues të Oliver Ivanoviçit. Ende në

pritje të veprimeve. I pari na vjen si një skandal korruptiv nga i cili distancohet secili politikan në Slloveni, por tek i cili bashkohet secili pushtetar në Kosovë. Martin Berishaj ka tërhequr plot 1.4 milion euro para të gatshme në njërën nga bankat e Prishtinës. Paratë janë transferuar nga kompania energjetike 'GEN-1' me seli në Beograd. Këto mjete e ky biznes janë mbajtur fshehtë. Prandaj ambasadori ka dy kallëzime të ndara penale. Një për shpëlarje parash e shmangie tatimesh,

një për fshehje të pasurisë. Ai vazhdon të marrë mbrojtjen e pazezervë të pushtetarëve vetëm sepse ka lidhje të ngushta politike me ta. Ligji për shokë të pushtetit vazhdon të mos vlejë. I dyti na vjen si rehabilitim i një kriminelit luftë. Oliver Ivanoviç ka qenë i dënau me 9 vjet burgim për vrasjen dhe përndjekjen e shqiptarëve civilë në veri të vendit. Si prijës i formacionit famëqar 'Rojat e Urës', ai kishte organizuar dhe urdhëruar vrasjen e 31 civilëve shqiptarë

para dhe pas luftës. Sot ai cilësohet nga pushteti si 'njeriu që punoi për një të ardhme të qëndrueshme e një Kosovë shumetnike'. 31 civilë të vrarë! 31 shqiptarë të vrarë nga njeriu multietnik i pushtetit. Cfarë mund të jetë më e dhimbshme se kaq?', ka thënë lideri i LDK-së. Abdixhiku ka shtruar edhe këtë pyetje: A është ky ndryshimi për të cilin Kosova ka pasur nevojë? "Që të amnistohen të korruptuarit vetëm sepse kanë lidhje me pushtet, e të

rehabilitohen kriminelët e luftës e pasluftës sepse tani janë në pushtet. Cfarë i bën të ndryshëm këta popullistë nga e mbrapshta që kishte ngufatur këtë vend? Skandalet si këto s'mund të kalohen në heshtje. Ato s'mund të mbyten as nga zhurma e paaftësisë të pushtetit. Do të vazhdojmë të kërkojmë shkarkim për të parin e kërkimfalje për lartnimin e dhimbshëm të të fundit. Kosova meriton më mirë. Kosova mundet më shumë!", ka thënë Abdixhiku.



Kurti kërkon nga ministrat më shumë angazhim

PRISHTINE, 23 JANAR - Gjatë dy ditëve të kësaj fundjave Zyra e Kryeministrit së bashku me kabinetet politike të ministrave kanë zhvilluar punëtori të përbashkët. Në këto takime të ndara sipas shtyllave bazë të Planit Kombëtar të Zhvillimit, ministrat prezantuan rezultatet, arritjet dhe sfidat e tyre gjatë vitit të kaluar si dhe planet dhe synimet për vitin 2023.

Kryeministri Kurti i falënderoi anëtarët e kabinetit qeveritar dhe stafin e tyre për punë përgjatë vitit 2022. Ai i ftoi ata edhe për më shumë angazhim në vitin 2023 për realizimin e punëve të nisura dhe zotimeve të programit qeverisës për qeverisje të mirë, siguri dhe sundim të ligjit, zhvillim të barabartë dhe ekonomi të fortë dhe të qëndrueshme.



Kurti e Çeku vizitojnë BIK-un, diskutohet për Projektligjin për Liritë Fetare

PRISHTINE, 23 JANAR - Kryeministri Albin Kurti së bashku me ministrin e Kulturës, Hajrulla Çeku, kanë vizituar sot (e hënë) Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK). Kurti e Çeku janë pritur në takim nga kryetari i BIK-ut, myftiu Naim Tërnavë. Siç njofton Zyra e Kryeministrit, Kurti ka shprehur mirënjohje

për myftiun Tërnavë për përkrahjen dhe kontributin e dhënë nga ai dhe Bashkësia Islame e Kosovës. "Në takimin e përbashkët me ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku dhe këshilltaren ligjore të kryeministrit, Tea Blakaj Hoxha, u bisedua edhe për Projektligjin për Liritë

Fetare. Kryeministri Kurti e falënderoi myftiun Tërnavë për bashkëpunimin për këtë projektligj. U theksua se qeveria e merr me seriozitet garantimin dhe respektimin e plotë të lirisë fetare, në mënyrë të barabartë, për të gjithë qytetarët pa dallim", ka njoftuar Qeveria e Kosovës.



MBAHET PROTESTA "KRYEMINISTËR, MOS NA SHKEL NË GJAK! STOP DEVIJIMIT TË HISTORISË"

Fëmijët e dëshmorëve kërkojnë dorëheqjen e Kurtit pas deklaratës për Ivanoviqin

Fëmijët e dëshmorëve të UÇK-së kanë protestuar të hënën kundër deklaratës së kryeministrit Albin Kurti për politikanin e ndjerë serb, Oliver Ivanoviq. Me moton "Kryeministër, mos na shkel në gjak! Stop devijimit të historisë", një numër i konsiderueshëm i tyre janë mbledhur para ndërtesës së Qeverisë së Kosovës. Një nga iniciatorët e protestës, Berat Beqiri, ka kërkuar nga Kurti të japë dorëheqje. "Deklaratat e pamatura do të pasohen me kundërshtimin tonë dhe me kërkesat tona për dorëheqje. Ky veprim i Kurtit ishte një tronditje e radhës dhe një fyerje e rëndë për të gjithë ne", ka theksuar ai



EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 23 JANAR - Fëmijët e dëshmorëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë mbajtur të hënën një protestë para objektit të Qeverisë së Kosovës për ta kundërshtuar deklaratën e kryeministrit Albin Kurti për politikanin e ndjerë serb, Oliver Ivanoviq. Kurti në pesëvjetorin e vrasjes së Oliver Ivanoviqit zgjodhi fjalë të mëdha për ta përshkruar atë si një person i përkushtuar për të luftuar për interesin e komunitetit dhe

qytetit të tij, duke theksuar se do të dëshironte që kujtimi i tij të mbetet i gjallë. "Kujtimi i tij si një njeri që punoi për një të ardhme të qëndrueshme dhe për një Kosovë shumetnike", pati thënë Kurti në mesazhin përkujtues për Ivanoviqin, i cili thuhet se është përgjegjës për vrasjen e 49 shqiptarëve gjatë dhe pas luftës në Kosovë.

Fëmijët e dëshmorëve me moton: "Kryeministër, mos na shkel në gjak! Stop, devijimit të historisë" kanë marshuar përgjatë sheshit "Skënderbeu" në Prishtinë. Një

nga iniciatorët e protestës, Berat Beqiri, ka kërkuar nga Kurti që të japë dorëheqje. "Ky veprim i Kurtit ishte një tronditje e radhës dhe një fyerje e rëndë për të gjithë ne. Fjalët e tij ishin shigjeta që ranë

mes nesh. Fjalimi i Kurtit ishte një rast i shëmtuar i një kryeministri që shkel historinë e popullit të vet. Me këtë protestë duam t'i themi stop. Me këtë protestë duam t'i themi secilit se me gjakun tonë

nuk bëhet tradhti. Me këtë protestë duam t'i themi secilit politikan, se nëse nuk jeni të aftë ta mbronni këtë vend, jepni dorëheqje e mos na torturoni", ka thënë Beqiri.

Këshilli Prokurorial kërkon nga Avokati i Popullit dërgimin e Ligjit të Pagave në Gjykatën Kushtetuese

PRISHTINE, 23 JANAR - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka njoftuar se i është drejtuar me kërkesë Avokatit të Popullit, që në zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, ta referojë Ligjin për Pagat në Sektorin Publik në Gjykatën Kushtetuese.

KPK-ja thotë se ka pasqyruar në këtë kërkesë komentet e vazhdueshme të cilat janë bërë në lidhje me këtë ligj. Sipas KPK-së, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Paga cenohet pavarësia dhe funksionalizimi i sistemit prokurorial për vetë faktin se kjo çështje është vendosur njëherë me Aktgjykimin numër 219/19 të Gjykatës Kushtetuese. "Të gjitha pretendimet e ngritura nga KPK-ja, të cilat janë dërguar

tek Avokati i Popullit, paraprakisht edhe te hartuesit e këtij Ligji, janë të mbështetura në aktet dhe praktikën ndërkombëtare, të cilat kanë paraparë në mënyrë taksative se kur mund të zbritet paga e prokurorit të shtetit. KPK shpreh gatishmërinë e plotë për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit me qëllim të referimit të këtij ligji në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës", thuhet në njoftimin e KPK-së.

Po ashtu, aty thuhet se KPK-ja përkrah hartimin e një Ligji për Pagat në Sektorin Publik, i cili duhet të jetë i bazuar në praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare dhe i cili nuk do ta cenojë pavarësinë dhe funksionalizimin e asnjë pushteti.



Presidentja Osmani pritet nga Papa Françesku në Vatikan

PRISHTINE, 23 JANAR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, është pritur të hënën në Vatikan nga Papa Françesku. "E lumtur të pritesha në audiencë private nga Papë Françesku në Selinë e Shenjtë. Papën e njoftova me vendosmërinë tonë për ta kultivuar e promovuar me tej paqen, harmoninë dhe bashkëjetesën ndërmjet njerëzve, si vlera të popullit tonë, mbi të cilat janë kultivuar e ruajtur prej afro dymijë vjetësh edhe raportet tona me Selinë e Shenjtë. Në mënyrë të veçantë e falënderova Atin e Shenjtë për kujdesin që ai po tregon ndaj Kosovës dhe e falënderova për vendimin e tij të

para pesë vjetëve, që Administratën Apostolike ta ngrinte në nivel të dioqezës. Ishte kënaqësi e veçantë, po ashtu, të shkëmbeja me të pikëpamjet mbi orientimin euroatlantik të Kosovës dhe progresin e vendit tonë drejt këtij synimi", ka shkruar Osmani në "Facebook".

Osmani ka theksuar se "thelimi i mëtejshëm i raporteve me Vatikanin dhe zgjerimi i bashkëpunimit në shumë fusha janë orientim ynë i përbashkët".

Presidentja Osmani ka thënë se synimi i Kosovës për njohje nga Vatikan kontribuon në këtë drejtim dhe në avancimin e mëtejshëm të raporteve tona shekullore.

Sipas tij, më mirë është të jesh një qytetar i panjohur sesa një kryeministër tradhtar. "Deklaratat e pamatura do të pasohen me kundërshtimin tonë dhe me kërkesat tona për dorëheqje. Ne sot ju themi se nuk jemi injorantë dhe as të paafetë dhe do të kërkojmë llogari publike. Ky popull as nuk harron dhe as nuk falë kurret", është shprehur ai. Këtë protestë e ka mbështetur edhe OVLUÇK-ja.

Ndaj kësaj deklarate të Kurtit në Ivanoviqin pati reagime edhe nga opozita dhe shoqëria civile.

Më 18 janar, në një aksion simbolik të mbajtur para qeverisë, Partia Socialdemokrate (PSD) ka vendosur para objektit të ekzekutivit një fotografi të

politikanit serb nga Kosova, Oliver Ivanoviq dhe një kurorë lulesh në të cilën shkruan "I pikëlluar, Albin Kurti". Molliqaj deklarantë të Kurtit e quajti skandalozë dhe tha se arsyeja e vendosjes së kësaj panoje është që për sa kohë që Albin Kurti të jetë kryeministër, ky do të jetë vendi ku ai duhet ta nderojë Ivanoviqin. "Bustin e Oliver Ivanoviqit e vendosëm para Qeverisë së Kosovës. Funksioni i bustit është i dyfishtë; ai ngushëllon Kurtin në njërin anë dhe shpërfaq tendencat e tij për rinterpretim të figurës së Ivanoviqit në anën tjetër. Ivanoviqi është kriminel luftë i dënuar; Kurti po dëshiron ta rinterpretojë atë përbrenda konfliktit të tij me

Vuçiqin. Kështu e transformon në punëtorin e devotshëm të përkushtuar për një Kosovë multietnike. Qëllimi nuk arsyeton metodën. Ngjarjet e individit, si në këtë rast Oliver Ivanoviq, nuk mund të jenë objekt rinterpretimi për teke të Kurtit. S'është thjeshtë hipokrizia, por rreziku i totalitarizmit që duhet të na shqetësojë. Përbalë saj kërkojmë demokraci dhe përgjegjësi. Kryeministër, kërko falje!", ka thënë Molliqaj.

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) ka theksuar përmes një reagimi se Oliver Ivanoviqi kishte përgjegjësi për ekzekutimin e 49 shqiptarëve gjatë dhe pas përfundimit të luftës në Kosovë. "Më 16 janar 2018, në

ora 8:15 të mëngjesit para zyrës së partisë që e drejtonte, në Mitrovicë ishte vrarë Oliver Ivanoviq, i akuzuar dhe i dënuar për krime lufte dhe shkelje të së drejtës humanitare me 9 vjet burg, ndërsa rasti ishte thyer në shqyrtim në Gjykatën Themelore në Mitrovicë. Oliver Ivanoviqi ishte një kohë deputet i Kuvendit të Kosovës sikur që portretizohej si lider i serbëve të verulit të Kosovës, ndërsa për KMDLNJ-në nuk kishte asnjë dyshim se ai kishte përgjegjësi komanduese dhe ishte urdhërdhënës për krime lufte dhe shkelje të zakoneve të luftës gjatë luftës së fundit në Kosovë sikur edhe për krime kundër njerëzimit pas përfundimit të luftës. Në bazë të dëshmiave nga dëshmitarët që i

mbijetuan ekzekutimit dhe fakteve të tjera të filmuara nga Halit Berani dhe bashkëpunëtorët në Qendrën Rajonale në Mitrovicë, Zyra e KMDLNJ-së në Prishtinë e akuzoi Oliver Ivanoviqin për vrasjen e 39 shqiptarëve, që të gjithë civilë të paarmatosur gjatë luftës sikur edhe 9 shqiptarëve dhe 2 boshnjakëve, në shkurt të vitit 2000 në Mitrovicën e Veriut, e ndarë dhe e okupuar nga forcat paraushtarake dhe parapolicore serbe. Kallëzimet penale kundër Oliver Ivanoviqit dhe personave të tjerë nuk ishin trajtuar fillimisht nga UNMIK-u e pastaj as nga EULEX-i, deri në kohën kur këto dyshime u bënë publike", është theksuar në reagimin e KMDLNJ-së.

Pas vërshimeve në Skenderaj, kryetari Nura bën thirrje për ndihmë

SKENDERAJ, 23 JANAR - Kryetari i komunës së Skenderajt, Fadil Nura, ka bërë thirrje për ndihmë pas vërshimeve në këtë komunë. Ai në "Facebook" ka bërë publik numrin e xhirollogarisë bankare, në të cilën njerëzit e vullnetit të mirë dhe përfaqësuesit e bizneseve mund të kontribuojnë për

ndihmë. "Të dashur njerëz të vullnetit të mirë, të dashur përfaqësues të bizneseve dhe të dashur bamirës, pas zyrtarizimit të procedurave për Fondin Emergjent për Vërshimet, me krijimin e xhirollogarisë bankare, u bëj thirrje të gjithë njerëzve vullnetmirë, përfaqësuesve të

bizneseve të mëdha e të mesme, bamirësve dhe të gjithë të tjerëve që kanë një mundësi të vogël, të na ndihmoni në rindërtimin e zonave të shkatërruara, rimëkëmbjen e familjeve të prekura nga kjo fatkeqësi dhe kthimin e jetës normale", ka shkruar Nura.



Sulmohet automjeti i policisë në Leposaviq

PRISHTINË, 23 JANAR - Automjeti i Policisë së Kosovës është goditur të hënën nga një veturë në lëvizje duke rrezikuar jetën e zyrtarëve policorë në Bistricë të Leposaviqit. Në këtë situatë policia thotë se për ta neutralizuar rrezikun ndaj tyre kanë shtënë me armë zjarrë. "Sot, më 23 janar, në Bistricë të Leposaviqit, një njësi policore ka qenë e caktuar me detyrë zyrtare në pikë kontrolli, me qëllim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike si dhe parandalimit të krimit e kontrabandës. Njësi policore e cila ka qenë në pikë kontrolli, gjatë realizimit të detyrave policore, ka tentuar ta

ndalojë një veturë, e cila gjatë lëvizjes ka goditur automjetin e Policisë së Kosovës, duke rrezikuar drejtpërdrejt edhe jetën zyrtarëve policorë, të cilët, për ta neutralizuar rrezikun ndaj tyre, kanë shtënë me armë zjarrë", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Policia ka theksuar se personat e dyshuar, së bashku me njetin e tyre, janë larguar nga vendi i ngjarjes, përdërisa hetimet lidhur me rastin janë duke u kryer në bashkëpunim me organet e drejtësisë. Lidhur me rastin, Policia e Kosovës ka njoftuar edhe Inspektoratin Policor të Kosovës për procedura të mëtejme.



Në vitin 2022 në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare u realizuan mbi 1 000 ndërhyrje kirurgjike



PRISHTINË, 23 JANAR - Gjatë vitit 2022 në Klinikën e Kirurgjisë Vaskulare të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë realizuar 1 202 e ndërhyrje kirurgjike, sipas raportit vjetor të punës. Prej tyre, janë kryer 316 vena varikoze, 102 urëzime (bypass) në ekstremitete, 44 intervenime në arteriet e qafës (karotide), 21 zgjerime të aortës abdominale (aneurizma) dhe

251 fistula arterio-venoze.

Për 12 muaj janë kryer edhe 468 operacione të llojeve të tjera si: intervenime për shkak të lëndimeve të enëve të gjakut, ekscizione të tumoreve dhe malformacioneve vaskulare, vendosje të porteve për kimioterapi, operacione në gjëndrën tiroide dhe operacione për shpulte diabetike.

Në Ambulancën Specialistike të Kirurgjisë Vaskulare janë bërë 8 164 vizita, derisa në klinikë kanë qenë të shtrirë 1 405 pacientë për trajtim. Klinika e Kirurgjisë Vaskulare ka arritur ta zvogëlojë listën e pritjes të operacioneve për vena varikoze dhe ka bërë plane për ngritjen e kapaciteteve për kirurgji endovaskulare.

Komuna e Podujevës fton qytetarët t'i lajmërojnë dëmet e shkaktuara nga vërshimet

PODUJEVË, 23 JANAR - Si pasojë e të rësuarave të mëdha të shiut ditët e fundit, shumë fshata e zona urbane të komunës së Podujevës janë përballur me vërshime. Me qëllim të evidentimit të të gjitha dëmeve të shkaktuara është krijuar Komisioni për Vlerësimin e Dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë

natyrore. Komuna e Podujevës i ka ftohur qytetarët që janë dëmtuar nga vërshimet t'i paraqesin kërkesat për kompensim të dëmit në objektin e administratës komunale në sportelin e shërbimit me qytetarë. "Bazuar në kërkesat e qytetarëve, Komisioni

Komunal do të dalë në terren dhe do ta shqyrtojë secilën kërkesë. Pas vlerësimit të dëmeve të shkaktuara nga kjo fatkeqësi natyrore, komisioni do t'u rekomandojë institucioneve qendrore kompensimin e dëmeve për qytetarët e komunës së Podujevës", ka njoftuar komuna e Podujevës.



Përparim Rama viziton qytetin e Lezhës

PRISHTINË, 23 JANAR - Kryetari i komunës së Prishtinës, Përparim Rama, ka vizituar komunën e Lezhës. Ai është

pritur nga kryetari Pjerin Ndreu. Rama ka falënderuar Ndreun për mikpritjen në qytetin historik të Lezhës.

"Jemi shumë entuziastë për bashkëpunimet mes qyteteve tona në të ardhmen, në veçanti në fushën e

agroturizmit, sektor ky shumë premtues për Prishtinën", ka shkruar Rama në "Facebook".



Danimarka ende po pret huazimin e qelive të Kosovës



PRISHTINË, 23 JANAR - Kosova nuk e ka ratifikuar ende traktatin për strehimin e qindra të burgosurve nga Danimarka, edhe pse dokumenti për këtë qëllim parasheh që transferimi i tyre të bëhet në tre muajt e parë të këtij viti.

Dy vendet kanë nënshkruar letër-pëlqimin për dërgimin e 300 të burgosurve nga Danimarka në Kosovë në dhjetor të vitit 2021, ndërsa në prill të vitit të kaluar dokumenti është shndërruar në traktat.

Traktati, i cili ka një kohëzgjatje prej dhjetë vjetësh, parasheh që Danimarka të marrë në shfrytëzim qeli të vetme dhe të përbashkëta në burgun e Gjilanit, ndërsa Kosova, në këmbim, të përfitojë mbi 200 milionë euro.

Nazlie Bala, këshilltare politike në Ministrinë e Drejtësisë në Kosovë, thotë për "Radion Evropë e Lirë" se investimet për përshtatjen e burgut të Gjilanit

me kërkesat e Danimarkës nuk kanë filluar ende, por se të gjitha planet investuese janë përgatitur. Këto plane, sipas saj, janë bërë gati nga ekipet teknike nga Danimarka dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës. Por, punimet nuk mund të fillojnë pa ratifikimin e traktatit në Kuvendin e Kosovës. "Traktati, i cili është nënshkruar nga Ministria e Drejtësisë e Kosovës dhe ajo e Danimarkës, e ka pjesë të veten edhe Marrëveshjen për Energji të Gjellbër, dhe pa nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje nga dy ministritë përgjegjëse [v.j. ministritë e Financave të të dyja shteteve], ne nuk mund ta procedojmë tutje traktatin, në Qeveri dhe Parlament, për ratifikim", thotë Bala.

Ministria e Financave e Kosovës nuk i është përgjigjur interesimit të "Radion Evropë e Lirë" se kur pritet të nënshkruhet Marrëveshja për Energji të

Gjellbër.

Parlamenti danez, në anën tjetër, e ka ratifikuar traktatin në fjalë vitin e kaluar.

Bala shpreh bindjen se ai pritet të finalizohet më së largu në fillim të muajit shkurt, prej kur, siç thotë ajo, do të mund të nisnin edhe investimet në burg.

Objekti i burgut në Gjilan - qytet në pjesën lindore të Kosovës - është ndërtuar në vitin 2015. Bala thotë se ai, kryesisht, i plotëson nevojat dhe standardet ndërkombëtare dhe se dhënia në shfrytëzim e qelive të tij për Danimarkën nuk do të marrë shumë kohë. "Besoj se ky proces do të jetë me dinamikën e planifikuar nga ekipet teknike nga Danimarka dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës", thotë Bala.

REL kontaktoi edhe qeverinë daneze, zyrtarë të së cilës thanë se presin që të dërgojnë të burgosur në Institucionin Korrektues të Gjilanit në Kosovë

siguruar se i plotëson kërkesat e shtetit dërgues - Danimarkës. Kapaciteti i burgut duhet të jetë i përshtatshëm për 300 të burgosur. Kapaciteti duhet të jetë në formën e qelive të vetme ose të qelive të përbashkëta. Qelitë e vetme duhet të kenë sipërfaqe jo më të vogël se 6 metra katrorë, kurse qelitë e përbashkëta jo më pak se 8 metra katrorë.

Danimarka nuk do të dërgojë të burgosur të dënur për vepra terroriste, të burgosur të dënur për krime të luftës dhe të burgosur të diagnostikuar me çrregullime të rënda mendore, të cilët kanë nevojë për kujdes mjekësor jashtë burgut.

Shteti i Danimarkës do t'i shfrytëzojë qelitë për pesë vjet nga hyrja në fuqi e Traktatit dhe mund t'i vazhdojë edhe për pesë vjet shtesë.

Udhëheqësit dhe gardianët në burgun e Gjilanit do të jenë nga shteti i Danimarkës dhe Shërbimi Korrektues i Kosovës.

Çfarë përfiton Kosova?

Nga zbatim i këtij traktati, Kosova do të përfitojë 210 milionë euro - 30 milionë euro do të shkojnë për energji të ripërtirshme dhe pjesa tjetër për investime në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Me hyrjen e tij në fuqi, shteti dërgues - Danimarka - do t'i dorëzojë Kosovës një tarifë fillestare prej pesë milionë eurosh, kurse gjatë 12 muajve të parë të shfrytëzimit të burgut pagesa do të bëhet në norma tremujore, në pajtim me numrin e të burgosurve që objekti mund t'i strehojë.

Shuma për 12 muajt e parë të përdorimit të burgut nuk duhet t'i kalojë 8.750.000 euro.

Ekspertë të sigurisë në Kosovë kanë thënë më herët për REL-in se nuk ka vend për t'u shqetësuar për situatën e sigurisë nga ardhja e të burgosurve nga Danimarka.

Por, përfaqësues të disa organizatave joqeveritare kanë thënë se ky transferim mund të ndikojë në standardin e të burgosurve lokalë.

Autoritetet në Danimarkë kanë thënë se kapacitetet e burgjeve të tyre janë mbushur 100 % pasi numri i të burgosurve është rritur për gati 20 % nga viti 2015.

sa më shpejt që të jetë e mundur. Rasmus Meldgaard, këshilltar për medie dhe komunikim në Ministrinë daneze të Drejtësisë, tha se traktati parasheh që Danimarka të nisë ta shfrytëzojë kapacitetin e burgut në Gjilan nga tremujori i parë i vitit 2023.

"Për nisjen e shfrytëzimit të burgut në Gjilan aktualisht jemi në pritje të ratifikimit të traktatit [nga Kosova] dhe zbatimit të masave ndërtimore të nevojshme për t'u siguruar se objekti është në gjendje të funksionojë në përputhje me kriteret daneze dhe detyrimet ndërkombëtare të Danimarkës", tha Meldgaard.

Çka parasheh Traktati ndërmjet Danimarkës dhe Kosovës?

Shteti pritës - Kosova - do t'i bëjë rregullimet e nevojshme në ambientet e burgut për të

Haradinaj: Kosova dhe Zvicra kanë miqësi të pathyeshme

PRISHTINË, 23 JANAR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka pritur të hënën në takim ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly. Haradinaj ka thënë se Republika e

Kosovës është falënderuese për përkrahjen e sinqertë dhe të vazhdueshme të Zvicrës në të gjitha proceset shtetndërtuese. "Bashkëbiseduam për çështjet aktuale në vend dhe thellimin e

bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe Zvicrës. Ambasadorin Kolly e falënderova për mbështetjen dhe miqësinë e pathyeshme e historike mes dy vendeve tonë", ka deklaruar Haradinaj pas takimit.



Ende s'ështëë caktuar vlera e koeficientit, të punësuarit nuk e dinë sa do ta kenë pagën në muajin shkurt

Edhe pse Ligji i Pagave është shpallur në Gazetën Zyrtare më 5 janar 2023, qeveria ende nuk e ka caktuar vlerën e koeficientit. Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se vlera e koeficientit do të shkojë javën tjetër në Kuvend për miratim. Ndërkaq ish-kryeministri Avdullah Hoti, duke folur rreth koeficientit të pagave, ka theksuar se një vlerë e koeficientit prej 125 eurosh i ruan pagat e njëjta në fuqi blerëse, siç kanë qenë në dhjetor 2021 përpara rritjes së çmimeve



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 23 JANAR - Edhe pse Ligji i Pagave është shpallur në Gazetën Zyrtare më 5 janar 2023, qeveria ende nuk e ka caktuar vlerën e koeficientit. Rrjedhimisht, askush nuk e di sa do ta ketë pagën në muajin shkurt. Kjo ka krijuar pasiguri të të punësuarit, pasi shumë prej tyre kanë kredi apo obligime të rregullta mujore. Mosaicaktimi i vlerës së koeficientit përbën shkelje të të drejtave të punëtorëve.

Ish-kryeministri Avdullah Hoti ka folur rreth koeficientit të pagave. Ai ka theksuar se një vlerë e koeficientit prej 125 eurosh i ruan pagat e njëjta në fuqi blerëse siç kanë qenë në dhjetor 2021 përpara rritjes së

çmimeve. "Pra, kjo vlerë e koeficientit nuk paraqet rritje reale të pagave. Rritje reale sigurohet nëse vlera e koeficientit është më e lartë se 125 euro. Çfarëdo vlerë e koeficientit më pak se 125 euro nënkupton ulje të pagave në fuqi blerëse në mallra dhe shërbime", ka shkruar Hoti në "Facebook".

Ai ka thënë se pagat në sektorin publik nuk janë rritur që nga viti 2016 kur u zbatua rritja prej 2-2 përqindësh deri në 20 përqind për shkak të viteve të përvojës së punës. "Për shkak të ndryshimeve strukturore në ekonomi dhe në nevojat për konsum të familjeve, si dhe inflacionit inercial për periudhën 2016-2021, është e natyrlshme që pagat reale duhet të rriten së paku 10 përqind.

Kjo rritje është modeste, pasi përbën rritje prej 2-përqindësh në vit. Kështu që, për të siguruar rritje reale të pagave prej 10-përqindësh, si dhe për ta kompensuar zhvlerësimin për shkak të inflacionit siç u diskutua më lart, vlera e koeficientit të pagave duhet të jetë 137.5 euro. [e njëjta përshtatje duhet të ndodhë edhe për skemat pensionale dhe të ndihmës sociale]", ka shkruar Hoti.

Shefja e deputetëve e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, ka thënë se vlera e koeficientit do të shkojë javën tjetër në Kuvend për miratim.

Ndonëse nuk tregoi se sa është vlera e koeficientit, Kusari-Lila tha se me këtë rast do të bëhet një plotësim-ndryshim i projektligjit për buxhetin që të jetë fiks vlera e koeficientit. "Koeficientin besoj shumë do ta përcjellë qeveria në Kuvend. Nëse jo këtë javë, javën tjetër do ta përcjellë për ta miratuar në kuadër të Projektligjit për Buxhetin. Me këtë rast do të bëhet një plotësim-ndryshim i Projektligjit për Buxhetin që të jetë fiks vlera e koeficientit, një praktikë që do ta thjeshtësojë shumë punën në trajtimin e pagave dhe koeficienteve në vitet në vijim", ka thënë Kusari-

Lila pas mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit.

Duke folur për pasojat e inflacionit, deputeti i LDK-së, Avdullah Hoti, ka thënë se për shkak të rritjes enorme të çmimeve të produkteve të konsumit të përditshëm, vlera reale apo fuqia blerëse e pagave u zvogëluar dukshëm gjatë vitit 2022. "Qeveria nuk i përshatit pagat për normën e inflacionit, as nuk e rriti pagën minimale. Rrjedhimisht, për pjesën më të madhe të familjeve (që kanë të ardhura vetëm nga paga) standardi i jetës ra për shkak të reduktimit të konsumit", ka thënë Hoti.

Rozeta Hajdari: Edhe 400 vende të reja të punës për qytetarët



PRISHTINË, 23 JANAR - "Edhe 400 vende të reja të punës për qytetarët tanë, me investimin e partneritetit kosovar-holandez në ciklin e plotë të integruar të prodhimit të produkteve të mishit të rosës në republikën tonë", ka thënë ministrja e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, me rastin e vizitës në biznesin "Duck to Convenience Kosova". Pronari i kësaj kompanie, Isa Tahiri dhe bashkëpunëtorët e tij paraqitën planet e mëtuqshme për zhvillimin e këtij biznesi që pritet të jetë shumë i dobishëm për qytetarët dhe vendin. "Duck to Convenience Kosova" aktualisht numëron 54 punëtorë, nga të cilët 80 përqind janë gra, por e ardhmja e afërt pritet të sjellë edhe 400 vende të reja të punës. Lajmi i mirë është se puna pesëvjeçare me shumë përkushtim nga ndërmarrësi i veshëm Tahiri, si i vetmi eksportues i certifikuar i mishit të rosës, ka bindur partnerin

holandez 'BR Tomassen Duck' që ta zgjerojë veprimtarinë me ciklin e plotë të integruar të prodhimit të rosës, nga ushqyerja, rritja e zogjve në ekonomitë familjare, prodhimi dhe qarkullimi për eksport i produkteve të mishit të rosës", ka theksuar Hajdari.

Ajo ka shtuar se "BR Tomassen Duck" është kompani serioze si prodhues i rosave dhe produkteve të mishit të rosave të sapongrira. "Po ashtu, aksionari kryesor i biznesit vendor 'Duck to Convenience Kosova', i specializuar në pjeke të rosave dhe eksport të produkteve të ndryshme të mishit të rosës në Gjermani, Holandë dhe Britani. Transferi i njohurisë dhe teknologjisë, me cilësi të lartë të produkteve të partnerëve aksionarë 'Duck to Convenience Kosova' dhe 'BR Tomassen Duck', do të jetë transformues kryesor i industrisë së ushqimit në republikën tonë", ka deklaruar ministrja Hajdari.

Lufta e re e klasave



Nga Jonathan RUTHERFORD

Gjatë dy dekadave të fundit, SHBA-ja është dominuar nga narrativa e rremë se po shkon drejt kolapsit dhe më pas nga kundër-reagimi. Historia mund të përsëritet në të gjithë botën perëndimore dhe askush nuk e ka treguar më mirë këtë sesa politologu amerikan Majkell Lind. Në librin e tij "Kombi i ardhshëm amerikan" (1995), Lind parashikoi riorganizimin politik në politikën amerikane shumë vite përpara se të shpërthente vala e populizmit kombëtar dhe demagogjisë së krahut të djathtë. Ai ka zhvilluar së fundmi idetë e tij në librin e ri "Lufta e re e Klasave (2020). Në këtë libër ai bën një analizë sfiduese të krizës me të cilën përballlet e majta perëndimore.

Ai mbështetet në tre argumente qendrore. E para është se shekulli XXI-të është epoka e nacionalizmit dhe e shtetit kombëtar. E dyta që ekonomia politike e së ardhmes nuk do t'i japë përparësi tregjeve të lira dhe ndjekës të 4 lirive abstrakte të mallrave, kapitalit, shërbimeve dhe njerëzve. Fokusit do jetë tek zhvillimi social dhe ekonomik kombëtar, atë që ne e quajmë nivelim. Dhe së treti, struktura klasore e shoqërive kapitaliste ka ndryshuar thellësisht përmes rritjes së një klase menaxheriale dhe kolapsit të pushtetit politik të klasës punëtore, në dem të madh të kësaj të fundit. Kjo klasë menaxheriale është tani forca dominuese në krahun e majtë.

A mund ta shpjegojmë pse e vlerësoni tak shumë nacionalizmin?

Nacionalizëm në kuptimin e "shtet-kombit" do të thotë se njësi politike është shtet-komb, në të cilin shteti për qëllime qytetare "huazon" gjuhën dhe kulturën e shumicës, edhe nëse përmban disa pakica kulturore. Pavarësisht se çfarë mund të ndodhë në të ardhmen, deri më sot shteti-komb është e vetmja njësi e qeverisjes që ka qenë në gjendje të mobilizojë ndjenjat ekstrapolitike popullore dhe identitetin

kombëtar për të përmirësuar gjendjen e shumicës së njerëzve, jo vetëm një oligarki apo aristokracia.

Pse mendoni se shekulli XXI do të jetë epoka e shtetit-komb?

E përse jo? Shekujt XVIII, XIX dhe XX ishin epokë e shtetit-komb. Po i tillë do të jetë dhe ky shekull. Format karakteristike të epokës agrare, perandoria dinastike, shumëkombëshe dhe qytet-shtetit, ia kanë lënë vendin pothuajse kudo shteteve-kombeve. Arsyeja është se shteti-komb kombinon shkallën e monarkive shumëkombëshe para-moderne me patriotizmin qytetar të qytet-shtetit republikan. Ndjenja e identitetit të përbashkët është e rëndësishme, sepse qeveritë dhe ekonomitë moderne janë komplekse dhe mbështeten në një nivel të lartë të legjitimitetit publik për të funksionuar.

Ju thoni "të majtë besojnë tek shteti, por jo tek kombi, ndërsa të djathtë besojnë tek kombi, por jo tek shteti". Partitë tona politike nuk janë të mirë-pajisura për ta ndjekur këtë lloj shtet-formimi....

Ato kanë qenë gjithmonë të papërgatitura. Në epokën moderne, partitë politike kanë përfituar nga burime relativisht jo-partiake dhe jashtë-politike të identitetit kombëtar dhe solidaritetit kombëtar. Historianët, artistët dhe kompozitorët kanë ofruar imazhet e përbashkëta të kombeve të veçanta, ndërsa sindikatat, kishat, bamirësitë, ekipet sportive, festivalat muzikore, klubet e veteranëve dhe të tjerë mund të promovojnë identitetin e përbashkët. Aftësia e liderëve politikë, edhe në regjimet despotike, për të krijuar dhe promovuar një "narrativë kombëtare" është shumë e kufizuar.

Argumenti juaj mbi domosdoshmërinë e një "identiteti të përbashkët", sugjeron që ju e refuzoni idenë e multi-kulturalizmit... Multi-kulturalizmi është i rëndësishëm në shoqëri si Zvicra apo Kanadaja (me komunitetet e tyre anglofone dhe frankofone), në të cilat dy ose më shumë

kombe etno-kulturore ruajnë përgjithmonë dallimin e tyre dhe ka pak martesë të përziera. Alternativa është modeli i "kazanit shkrirës", në të cilin dy ose më shumë grupe bashkohen kulturalisht dhe demografikisht nëpërmjet martesës.

Për përvojë na thotë vazhdimisht se ky model është zëvendësuar nga metafora e "tasit të sallatës", në të cilën përbërësit ruajnë dallueshmërinë e tyre. Por ky nuk është rasti i SHBA-së, ku pasardhësit e emigrantëve të të gjitha prejardhjeve përen të ndajnë kulturën amerikane dhe anglishten amerikane.

Kritja e normave të martesës të përziera po i mjeçullon vijat ndarëse midis të ashtuquajturve të bardhë johispanikë, aziatikë, hispanikë dhe afrikano-amerikanë në SHBA, duke i bërë gjithnjë e më të padobishme këto kategori. Mbretëria e Bashkuar është bërë një "kazan shkrirës". Kryeministri aktual është britanik me prejardhje indiane.

Por unë pyes: Nëse shoqëritë perëndimore po bëhen kuzanët e shkrirjes trans- raciale, jo sallata multi-kulturore, atëherë pse elitat e qeverisë, korporatave, akademike dhe mediatike po forcojnë politika të tilla si diversiteti, barazia dhe përfshirja (DEI) bazuar në idenë e rreme se hendeqet midis grupeve racore dhe etnike janë të përherëshme apo edhe në rritje? Përgjigja është se theksi i vazhdueshëm mbi pabarazitë racore dhe etnike e largon vëmendjen e publikut nga ndarja klasore në rritje në Perëndim midis klasës tepër të arsimuar në universitetet dhe klasës punëtore, anëtarët e të gjitha racave të së cilës kanë më shumë të përbashkëta me njëri-tjetrin sesa me anëtarët e elitës, kur bëhet fjalë për pagat, fuqinë punëtore, qasjen në sistemin arsimor dhe atë shëndetësor.

Dhe si do ta përshkruanin konfliktin midis dy klasave?

Nuk ka nevojë të jesh marksist për ta pranuar se shumica e asaj që është e koduar si "konflikt kulturor", përfshin në fakt

përplasje të interesave ekonomike midis klasës tepër të arsimuar dhe klasës punëtore. Një shembull është emigracioni. Emigrantët më pak të arsimuar dhe me paga të ulëta mirëpritën si shërbëtorë me kosto të lirë apo punonjës shërbimi nga elita, por shihen si konkurrentë për vendet e punës dhe në disa raste për programet e kufizuara të mirëqenies nga shumë pjesëtarë të klasës punëtore.

Ju e refuzoni pikëpamjen se kundërshtimi ndaj emigrimit ka të bëjë thjesht me racizmin ose etnocentizmin, por ka një shkak ekonomik. Mund ta shpjegojmë këtë?

Unë përdor termin "treg i ndarë i punës", që u shpik nga sociologia Edna Bonaçik. Ai shfaqet sa herë që fuqia punëtore ndahet në dy grupe, njëri prej të cilëve është i gatshëm, për çfarëdolloj arsye, të punojë për paga më të ulëta dhe në kushte më të këqija sesa tjetri, duke i lejuar punëdhënësit t'i vendosin të dyja grupet kundër njëri-tjetrit, duke ulur pagat dhe standardet. Shpeshherë ky fenomen mer formën e konkurrencës mendis vendasve dhe emigrantëve, por grupe të ndryshme emigrantësh mund të konkurrojnë gjithashtu me njëri-tjetrin, si dhe punëtorët nga rajone të ndryshme brenda një vendi. Ata që promovojnë nivele më të larta të emigrimit përsërisin vazhdimisht pretendimin se emigrantët nuk pranojnë të paguhen pak dhe as të punëohen nga punëtorë të natyralizuar në SHBA dhe Evropën Perëndimore.

Kjo është e vërtetë në disa profesione.

Por ka shumë raste të shumë industrive në SHBA, duke filluar nga paketimi i mishit tek shërbimet shtëpiake e deri tek ndërtimi i shtëpive, në të cilat punëdhënësit e kanë përdorur qasjen tek fuqia punëtore emigrante për të zëvendësuar punët me paga të larta me paga të ulëta, duke e zbehur ndikimin e sindikatave.

Marrë me shkurtime nga "New Statesman"
-Bota.it



EURO GLASS
Adri Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Paçarada: Krenar që do ta vesh fanellën e Kolnit

KOLN, 23 JANAR - Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Leart Paçarada, është futbollisti më i ri i ekipit gjerman të Bundesligas, FC Koln. Në fakt zyrtarizimin e transferimit e kanë bërë këta të fundit përmes njëfimit në rrjete sociale. Koln ka bërë me dije se Paçarada aventurën e

nis nga sezoni i ri si agjent i lirë dhe është blerja e parë e sezonit 2023/2024. Kosovari ka nënshkruar kontratë me klubin e ri deri në vitin 2026. Paçarada këtë sezon me St. Paulin ka shënuar 1 gol dhe ka asistuar 4 herë në Bundesliga 2. Ndërsa një sezon më herët ishte më i miri në pozitën e tij

si mbrojtës i krahut të majtë duke asistuar 10 herë. "Jam jashtëzakonisht krenar që vesh fanellën e Kolnit nga sezoni i ardhshëm. Një qytet i tërë që e jeton dhe e do këtë klub me plot emocioni", ka thënë Paçarada. "Rikthimi në qytetin ku jam rritur dhe që ka qenë gjithmonë shtëpi për

mua është një ndjenjë e papërshkrueshme për mua. Mezi pres të mbaroj në Mungersdorf. Por deri atëherë, fokusi im i plotë do të jetë te FC St. Pauli, të cilin i detyrohem shumë dhe me të cilin dua të kujtohem gjithmonë pozitivisht", ka deklaruar Paçarada.



Përballja e kampioneve në Ligën Unike

PRISHTINË, 23 JANAR - Xhiroja e shtatit në Ligën Unike të Femrave do të dhurojë disa ndeshje mjaft interesante. Sfida e parë do të jetë mes Penzës dhe Flamurtarit apo kampiones së Kosovës dhe Shqipërisë. Në këtë edicion skuadra pejane ka dy fitore e katër humbje, kurse ajo nga Vlora, pesë fitore dhe një humbje. Humbjen e parë e pësoi javën e kaluar nga Bashkimi, megjithatë vashat vlonjate së fundi fituan Kupën e Shqipërisë dhe janë të motivuara më shumë për të fituar trofe, kurse kampionet e Kosovës me përforcimet e fundit kanë ngritur ambiciet. Ndeshja e dytë është derbi i Kosovës mes Bashkimit dhe Prishtinës, ku këto dy skuadra u takuan edhe në Superligën e Femrave, me



LIGA UNIKE E FEMRAVE - JAVA 7
TË MARTËN TAKOHEN:
17:00 PENZA - FLAMURTARI
19:00 PRISHTINA - BASHKIMI
TË MËRKURËN TAKOHEN:
19:00 TIRANA - PARTIZANI

prizrenaset që vazhduan të jenë të pamposhtura në elitën e femrave në Kosovë. Në Ligën

Unike të dyja skuadrat kanë nga tri fitore e tri humbje, andaj kjo sfidë është shumë e rëndësishme.

Takimi i fundit i kësaj jave është mes Tiranës dhe Partizanit apo derbit të qytetit. Tirana ka një

fitore e pesë humbje, ndërsa Partizani numëron katër fitore e dy humbje në këtë edicion.

Olivier nga Malisheva kalon te Ballkani



SUHAREKË, 23 JANAR - Kampioni në fuqi i Kosovës në futboll, Ballkani, po vazhdon ndryshimet para fillimit të sezonit pranveror në elitën e futbollit të Kosovës. Kjo skuadër të hënën e ka zyrtarizuar transferimin e sulmuesit Yoan Marc-Olivier nga Malisheva. Sulmuesi anglez një kohë ishte paraqitur

edhe për skuadrën e Istogut. "Sulmuesi Yoan Marc-Olivier është zyrtarisht futbollist i skuadrës sonë! Sulmuesi 22-vjeçar ka firmosur ditën e sotme me klubin tonë një kontratë dyvjeçare. 22-vjeçari Olivier vjen te Ballkani nga kampionati ynë, ku së fundmi ishte pjesë e FC Malishevës. Klubi ynë i uron mirëseardhje

dhe shumë suksese me fanellën e skuadrës sonë", thuhet në njoftimin e skuadrës së Ballkanit. Skuadra e Ballkanit sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e dytë me 38 pikë, po aq sa ka edhe Drita në vendin e parë. Klubi suharekas në fundjavë e fitoi Superkupën, pasi në finale e mposhti Llapin (1-0).

Flamurtari fiton Kupën e Shqipërisë në basketboll

DURRËS, 23 JANAR - Flamurtari shpallet fitues i Kupës së Shqipërisë në basketboll për femra, pas fitores 74-73 në finale ndaj Partizanit, në ndeshjen e luajtur në mjediset e akademisë "Dhimitraq Goga" në Durrës. Një finale e vendosur në frymën e

fundit, me të kuqtë që patën aksionin e fitores, por gabuan në fund. Ndeshja ishte e ekuilibruar nga minuta e parë deri tek e fundit, me të dy ekipet që e kërkuan me ngulm fitoren, duke dhuruar emocione në parket. Vlonjatet u treguan më të saktanë

aksionin e fundit, duke përfutur edhe nga gabimi që të kuqtë bënë në sulmin e fundit, që mund t'u jepte atyre fitoren. Në fundin e takimit, Partizani pretendoi për një gabim të gjyqtarëve, por ky pretendim u hodh poshtë. Flamurtari e Partizani janë dy

ekipet më të mira të kampionatit, kryesuese edhe në Ligën Unike për femra, fakt që e konfirmoi edhe finalja e fundit në Kupën e Shqipërisë. Një fitore e merituar për skuadrën e trajneres Elona Hasanaj që kryeson edhe kampionatin.



Fury: Këta janë dy rivalët e këtij viti, Joshuan s'dua ta shoh me sy

Londër, 23 janar - Boksieri britanik Tyson Fury, kampion bote në peshën e rëndë (kategoria WBC), ka hedhur poshtë idenë e një përballje me patriotin e tij Anthony Joshua. Ai konfirmoi se në planet e tij për këtë vit janë dy duela: Ai i unifikimit të

tijutje kampionë ndaj ukrainasit Oleksandr Usyk dhe sfida ndaj Francis Ngannou (ish-kampion bote në peshën e rëndë në artet marciale mikse). Në lidhje me bisedimet që palët po bëjnë për duelin ndaj Usyk, Fury ka deklaruar: "Nuk e di se në

çfarë pikë janë bisedimet, por po bëj maksimumin që kjo sfidë të zhvillohet sa më shpejt. Unë dua të dueloj ndaj Usyk dhe për momentin nuk jam i interesuar të zhvilloj ndonjë sfidë tjetër. Kjo është sfida e shekullit dhe dua të jem pjesë e saj. Nëse

kjo përballje ndaj Usyk nuk zhvillohet tani, atëherë do ta shoh mundësinë që të përballem me Francis Ngannou. Këto janë planet e mia, për të zhvilluar këto dy sfida gjatë vitit 2023. Anthony Joshua nuk hyn në planet e mia për këtë vit, madje as që



dua ta dëgjoj atë emër", u shpreh Tyson Fury, i pamposhtur në karrierën e tij.

Daniels, MVP i javës në Superligë

MITROVÇE, 23 JANAR - Trepça triumfoi në derbin ndaj Pejës në udhëtim, ku më i miri në parket për mitrovicasit ishte qendra Will Daniels. Ai për 24 minuta në parket kishte 25 pikë, nëntë kërcime, një asistim, dy topa të vjedhur dhe një bllokadë. Daniels ishte më i miri i kësaj ndeshjeje dhe zhvilloi 19. Ai u ndihmu nga Mikale Tmusiq me 20 pikë e gjashtë kërcime. Tmusiq dalëngadalë po rikthehet në formën e dikurshme. Dardan Berisha zhvilloi një ndeshje të jashtëzakonshme përballë Bashkimit. Kapiteni i Kosovës ndaj prizrenasve realizoi 29 pikë, gjashtë kërcime e shtatë asistime, duke qenë basketbollisti më i mirë i ndeshjes dhe ndër më të mirët e kësaj jave. Ponte Prizreni u rikthye fitoreve, ku mundi Rahovecin, ndërsa u dallua basketbollisti i Kosovës, Meriton Ismaili. Ai shënoi 28 pikë apo shtatë herë nga tri pikë nga nëntë

WILL DANIELS

25 PIKË
9 KËRCIME
1 ASISTIM

Top pesëshja

Will Daniels (Trepça) 25 pikë, 9 kërcime, 1 asistim
Dardan Berisha (Sigal Prishtina) 29 pikë, 6 kërcime, 7 asistime
Meriton Ismaili (Ponte Prizreni) 28 pikë, 2 kërcime
Mikale Tmusiq (Trepça) 20 pikë, 6 kërcime
Gëzim Morina (Golden Eagle Ylli) 13 pikë, 6 kërcime, 2 asistime

tentime sa i kishte. Golden Eagle Ylli vazhdoi me fitore, që ishte e 15-të ndaj Vëllaznimit, ku më i miri ishte kapiteni i therandavse

dhe qendra e Kosovës, Gëzim Morina. Ndaj kuqezinjve kishte 13 pikë, gjashtë kërcime dhe dy asistime.

Humbin Denveri, Golden State dhe Memphisi, triumfojnë lakersat

PORTLAND, 23 JANAR - Humbja e dytë radhazi për Memphisin ndaj Denverit në Perëndim. Memphisi u mund me rezultat 112-110 nga Phoenixi, ndeshje ku për Suns-in u dalluan Bridges me 24 pikë e Pauli me 20. Fitoren e dytë radhazi e korrën lakersat, që mundën me rezultat 121-112 Portlandin jashtë fushës, duke shpresuar për "play-off"-in. LeBron Jamesi me 37 pikë e 11 rebounde e Thomas Bryant me 31 pikë e 14 rebounde bënë dallimin në fushë për lakersat. Humbet



skuastra kampione e Golden States, që në fushën e saj u mund 120-116 nga Brooklyn. Irvingu me 38 pikë ishte lider në parket për Netsin, duke i bërë të pavlefshme 26 pikët e Curry për Warriorsi. Miami, falë 26 pikëve të Tyler Herros, mundi me rezultat 100-96 New Orleansin

dhe ruajti zonën "play-off", ndërsa Dallasi u mund me rezultat 112-98 në shtëpi nga clippersat. Për miqtë u dallua Kawhi Leonard me 30 pikë. Befasia është humbja e Denverit, 101-99 nga Oklahoma, ndeshje ku u dallua Alexander Shai me 34 pikë.

REZULTATET

DALLAS - CLIPPERS	98-112
MIAMI - NEW ORLEANS	100-96
TORONTO - NEW YORK	125-116
DENVER - OKLAHOMA	99-101
PHOENIX - MEMPHIS	112-110
GOLDEN STATE - BROOKLYN	116-120
PORTLAND - LAKERS	112-121

Trajneri i Al Nassrit, Garcia: Ronaldo, i rëndësishëm për ekipin tonë

Trajneri i Al Nassrit, Rudi Garcia, ka thënë se Cristiano Ronaldo ishte i rëndësishëm për ta ndihmuar ekipin e tij ta siguronte fitoren ndaj Al Ettifaqit të dielën edhe pse ai nuk ishte i përfshirë

në golin e vetëm të ndeshjes. "Është një shtesë pozitive kur ke një lojtar si Ronaldo pasi ai ndihmon për t'i shpërqendruar mbrojtësit, gjë që ndodhi me golin tonë", ka thënë Garcia.

"Krijua mundësi dhe u kërkua lojtarëve ta diversifikonin lojën mes tij dhe Taliscas dhe nuk duhet të harrojmë se ai mori pjesë në ndeshjen miqësore ndaj PSG-së

dhe nuk ka pushuar mjaftueshëm. Edhe me Cristiano Ronaldo në ekip nuk është e lehtë ta fitosh Ligën Saudite për shkak të fuqisë së konkurrentëve", ka shtuar Garcia.

Fitorja e Al Nassrit i ktheu ata në krye të renditjes së ligës me 33 pikë në 14 ndeshje. Ata janë një pikë përpara Al Hilalit të vendit të dytë, i cili ka luajtur një ndeshje më shumë.

SHKURT

Zhegrova synon ta fitojë Kupën e Francës

Edon Zhegrova ka bërë paraqitje të shkëlqyeshme në Kupën e Francës, të cilën synon ta fitojë me Lillen. Ai e ndihmoi ekipin e tij në fitoren 2-0 ndaj ekipit Pau në fundjavë. Zhegrova kontribuoi në golin e parë duke e detyruar futbollistin kundërshtar, Kouassi, të shënojë autogol. Golin e dytë të vendësve e realizoi Gomes. "Ndeshtet si kjo nuk janë kurrë të lehta kundër një ekipi që mbrohet shumë. Është mirë që e fituam lojën dhe që u kualifikuam për në raundin tjetër. Tash synim yni është ta fitojmë Kupën. Duhet të bëjmë gjithçka për ta arritur këtë qëllim", ka thënë Zhegrova.

Mulleri: E kam për detyrë të jap gjithçka për ekipin


Thomas Muller si rrallëherë do ta niste sfidën ndaj RB Leipzigut nga bankina pasi trajneri Julian Nagelsmann kishte vendosur ta reshtonte Gnabryn në vendin e tij. Gjithsesi, kjo lëvizje nuk është pritur negativisht nga 33-veçari: "Çdo trajner ndërton skemat e tij mbi bazë të kundërshtarit. E kam për detyrë të jap gjithçka, pavarësisht minutazhit në këmbë. Gjithashtu ju them se me Nagelsmannin kam komunikim të shkëlqyer".

Haalandit i mjaftojnë 19 ndeshje për ta kaluar Ronaldon

Erling Haaland vazhdon të konfirmohet si një makineri e frikshme golash. Manchester City mposhti djeg 3-0 Wolvesin falë tre golave të sulmuesit norvegjez, i cili është ngjitur në kuoën e 25 golave në kampionatin anglez. Kjo shifër e pabesueshme është arritur në vetëm 19 ndeshje, ndërkohe që në renditjen e golashënuesve më të mirë në Premierligë e ndjek Harry Kane me dhjetë gola më pak. 22-veçari shënoi tregolëshin e katërt në ishull, duke parakaluar një legjendë si Cristiano Ronaldo, autor i vetëm tre tregolëshave në Premierigë.

Arteta: Nuk mund të shkote më mirë se kaq

Skuadra e Arsenalit është duke shkëlqyer këtë edicion në Premierligë. Arsenali është pesë pikë larg Manchester Cityt në krye të renditjes tabelore, ndërsa ndeshjen e fundit e fitoi kundër Manchester United (3-2). Trajneri i Arsenalit, Mikel Arteta, është shumë i kënaqur me rezultatet që po arrin skuadra që e drejton. "Emocional, shumë pasion, shumë cilësi. Nuk bëhet më mirë se kaq. Pas derbit kundër Tottenhamit, të vijë kundër Manchester Unitedit dhe të luajmë në këtë mënyrë që luajtmë. Në pjesën e dytë performanca ishte e pabesueshme. Ne ishim të kompozuar dhe të vendosur në të njëjtën kohë. I menaxhuam momentet në lojë. Nuk na kapi asnjëherë paniku. Gjithmonë kemi besuar se mund të fitonim. Treguam qetësinë e duhur në zonë shumë herë, por topi nuk hyri brenda", ka thënë Arteta.



Lumë's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letërën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Sali Rashiti shpall të pavlefshme certifikatën e Aftësitimit Profesional, në modulet hyrje në profesionin murator, mbrojtja dhe siguria në punë, veglat dhe materialet në profesionin e muratorit llogaritja ekonomike, realizimi i mureve me tulla dhe blloqe, Ferizaj 07.10.2019.
- Hadije Beqiri shpalle te pavlefshme dëftesat prej klases se 5-8 te shkollës fillore TREPÇA
- Gentian S Rama shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 811323708.
- Lirigzon Osmani shpalle te pavlefshme dëftesat e SHMLT " Arkitekt Sinani".
- Mentor Haxhiu B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 601640726.
- Arlind Brahimi shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore" Shaban Idrizi".
- Edon Mehmeti shpalle te pavlefshme dëftesën e klasës se 10-te te SHMLT " Arkitekt Sinani".
- KAstriot Aliu shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLE " Hasan Prishtina".
- Kaltrina Adancic B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 810385600.
- Perparim Shatri shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Hysni Temaj " Kushnin Has.
- Dardan Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu " Nazim Kokollari " Prizren.
- Begjet Kryeziu shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Fadil Hisari " Prizren.
- Albin Jusufi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- Samedin Krasniqi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- Gëzim Markaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XI të shm Teknikë "Nexhmedin Nixha.
- Eduard Gjurgia nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shm "Nexhmedin Nixha".
- Egon Beqiri nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.
- Pranvera Arllati nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu "Zekiria Rexha" Gjakovë.
- Muje Istrefi shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT " Arkitekt Sinani".
- Shkelzen Sylejmani B.I shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 811403956.
- Bekim Rexhepi shpalle te pavlefshme dëftesat dhe diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani".
- Miran Hasani shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLT "Arkitekt Sinani (Ish Boris Kidric).
- Fitim Koca shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore " Migjeni".
- Kadri Musliu shpalle te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore " Trepça".
- Ardian Brahimi shpalle te pavlefshme dëftesën nga klasa 6-9 te shkollës fillore " Shaban Idrizi".
- Granit Aliu shpalle te pavlefshme diplomën e SHMLE " Hasan Prishtina".
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

(Listed in alphabetical order)

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola CeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

